Vehbi
Bala

Epigrame

"M. EMINESCU"
BIBLIOTEKA
26
105

BIBLIOTEKA CENTRALĂ UNIVERSITARĂ "CAROL I"

F 26
105C
891.983-93-1
BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
S H K O D E R

Vehbi Bala

Epigrame

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

Ilustrimet: Zef Bumçi

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
S H K O D E R

EPIGRAMET

Unë epigrame thur me mall prej vendi
dhe borxh askujt s'i marr t'i thur ato.
Me to godas çdo ves edhe këdo,
paçka se var ti buzët, kur t'përmendi.
E di se kam me vete një pushtet,
që vetëm të vërtetën e mbështet.

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHI KUKUDESH

PORTRETE DHE SYFETE

Në shoqërinë tonë ka portrete
të bukur njerëzish me vlerë e t'rinj,
po çoku kanë ngelur dhe syfete,
që duhen kritikuar me mëri.

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLEJ"
SHKODER

UNË, VEHAB LABI

Vehab më thonë, Labi e kam llagapin.
Në punë e ndiej kënaqësinë e jetës.
Bëj vrapin vetëm aq sa e kam hapin
dhe kurrë nuk i trembem së vërtetës.
Revolucioni dhe kjo dashuri
për jetën, më mbajnë gjithnjë të ri.

BIBLIOTEKA PUBLIKE
„MARIN BARLETI"
S H K O D E R

AI QË ËSHTË NË LARTËSINË E DETYRËS

Kush është i aftë e me ndërgjegje t'pastër,
nuk rreh as gjoks dhe as nuk rreh tryezë,
s'përdor as lustër, nuk përdor as llashtër,
dhe tjetrit s'i kërkon qimen në vezë.



BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

VLERA

Kush do të çajë rrugën për në jetë,
lëmoshë nuk kërkon nga miq e shokë,
me brryle nuk godet njeri mbi tokë,
po ecën drejt me punën që bën vetë.
Te ne çdo vlerë, herët ose vonë,
të çmohet një herë e përgjithmonë.

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
S H K O D E R



DITURIA

Dituria nuk dhurohet,
as nuk blihet me para,
po me mund sa rron fitohet
edhe prap mbarim nuk ka.

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
S H K O D E R

KËSHILLË

Me të djeshmen mos u mburr,
kur merita sot nuk ke!
Bota nuk të pyet kurrë
si ke qenë, po si je.

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER

ASTEIZËM*

Paskemi qenë të pagdhendur fare,
ne, që, dikur, kem' qenë ende të rinj!
Paskemi pasë thjeshtësi «vulgare»
në sjellje, shprehje dhe në shoqëri!
Nuk jemi mbajtur bash si qytetarë,
kemi nderuar rrugës të moshuar,
e kemi folur shqipen si të shplarë,
shijen «moderne» s'e kemi pranuar.
Kështu mendon për ne ai qafëleshi
dhe shoqja e tij diku me minifund.
Rinia don t'i bindë, n'mos për veshi,
do t'i mbërthejë mirë e do t'i shkundë.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

---

*) **Asteizëm** është një figurë stilistike me anë të së cilës shajnë për të lavdëruar.

ATIJ QË E KA ZEMRËN FORT TË BARDHË

E ke zemrën fort të bardhë
dhe vërtet je darovar,
po ke t'bësh dhe me zuzar,
që të zhvat e t'quan budallë. . .

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
S H K O D E R

SASI DHE CILËSI

Flet lapërdhi ai që mendon fort pak.
Flet pak e sakt ai që mendon më shumë.
Më mirë folë pak edhe tirjak,
se sa të flasësh shumë edhe për lumë.

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
S H K O D E R

NJË PENSIONISTI

Uroj që ta kalosh pensionin, vlla,
me gruan, në e ke dhe e paç për krah,
me nipa e mbesa, shoqëri dhe jo
me taull, dagërxhim a domino.
Pensioni është fund i një shërbimi,
po kurrsesi mbarim i një gjallimi.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

NJË KUKULLE

Përse, moj femër, më llastohesh
se je e hijshme në të parë;
më mbahesh rëndë e pispillosesh
si kukull shitur në pazar?
Ç'e dua hijeshinë tënde,
kur kokën ti e ke pa mendje?
M'e bukur është mendja n'kokë
se kukullat me okë e okë. . .

BIBLIOTEKA KOMBËTARE E SHQIPËRISË "MARIN BARLETI"

NUSES

Pastron, gatuan e gjora vjehërr,
ta mban dhe foshnjen ajo në prehër
dhe prapseprapë ti e ke resë. . .
(Eh, fjala jote - kokrra e rrufesë!)
Nuk e kuptoke, me tërë mend,
se është nëna e burrit tënd?!

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
S H K O D E R

VJEHRRËS

Punon n'ndërmarrje e shkathta e re,
vjen në familje punon me nge
dhe prapëseprapë ti e ke resë. . .
(Eh fjala jote - topuz me presë!)
Nuk e kuptoke, me tërë mend,
se është nusja e djalit tënd?!

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER

QESHEM, SE NUK MUND PËR TY TË QAJ

Me ty shpeshherë unë ndeshem
dhe ti vazhdon të njëjtin faj;
më vjen aherë fort të qeshem,
sepse nuk mund për ty të qaj. . .

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" S H K O D E R
BIBLIOTEKA E SHTETIT
SHKODER
F 19168

NJË SENTIMENTALISTI

Me afshe, ofshe dhe me lotë,
për nder, s'kalohet dot kjo botë,
prandaj të quajnë zemërpulë.
I mjerë ti, kur fryn një shqotë,
or sentimentalist me vulë!

BIBLIOTEKA QENDRORE "MARIN BARLETI" SHKODER



NJË KRITIKU LETRAR

Ti, kritik, gjithkund merr erë
dhe pickon mu si një plesht,
po kritika t'del përherë
send që s'është mish as peshk.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER



NOVATORIZMIN NUK E BËN NJË NOVATOR I VETËM

I ngrite vetes monument së gjalli,
si lashtazi Horaci dhe Marciali.
Po a nuk e ditke të vërtetën, vallë,
se s'ngrihet monument pa piedestal?

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

AI QË BËN SI TARTARINI

Trillon si Tarţarini i Taraskonit
dhe vlerë i njeh vetvetes tek s'e ka.
Po ne s'ia varim dot atij zakoni,
sipas të cilit qimja bëhet tra.
Në Francë «trimi» e bënte mizën buall;
këtu, në Shqipëri, për të s'ka truall.
Në vend të vet pat shesh që la përshesh;
këtu ai njihet menjëher' mes nesh.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER

KUNDËR TIFOZLLËKUT

Tifozët e futbollit na mbuluan.
Ilaçet e gjersotme s'i shëruan.
Ka mbetur vetëm një ilaç i ri:
futbolli të ngrihet në cilësi.

BIBLIOTEKA PUBLIKE
„MARIN BARLETI"
S H K O D E R

KRITIKË

Ti nuk e kritikon, se ia ke frikën,
mos edhe ai ka për të t'kritikuar;
madje e lavdëron pa pas' meritën,
se edhe ai ka për të t'lavdëruar.
Po ne ju njohim tash të dyve mirë
dhe do t'ju kritikojmë pa mëshirë.

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
S H K O D E R

DY «JETË»

Në skenë lot fytyrën
e burrit me moral,
në jetë shfaq natyrën
e «trimit» ilegal.
Besim si mund të kenë
dy «jetë» në një skenë?!

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
S H K O D E R

KUNDËR SMIRËS PROFESIONALE

Pse ai krijon
gjithnjë më mirë
e ke inat
dhe shpif ndaj tij.
Sa t'poshtëron
e zeza smirë
si në zanat,
në shoqëri!

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
S H K O D E R

GËNJESHTARIT

Duhet mbajtur fjala e dhënë,
n'je shqiptar me bes' të shenjtë.
Si bën ti, duke na rrejtë,
fort dyshoj me kë je zënë...
Në të lënçim, na bën gjëmën,
vendin e gënjen dhe mëmën...

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
S H K O D E R

NJË KOPRRAČI

Koprrac i madh, or burrë, paske qenë!
Më thonë se kursim të madh ke bërë.
Familje s'ke. Nga trupi mjaft ke rënë.
Paraja n'varr s'të ka më asnjë vlerë.

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
S H K O D E R

ATIJ QË NUK SHLYEN BORXHIN

Më more borxh njëherë e nuk ma ktheve.
Të dytën herë nuk ma ktheve prap.
Të tretën herë më nuk më gënjeve,
se nuk të dhashë gjë, as më s'të jap.

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
S H K O D E R

VJEDHËSIT TË SUBJEKTEVE

Më vodhe një subjekt për njërën vepër,
po personazhet dolën vetëm lëndë,
se nuk ma vjedh dot shpirtin, aq më tepër
mendimin, me të cilin veprat end.

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
S H K O D E R

MOSKOKËÇARËSI

E zhgrehu fare me leximе e shfaqje,
s'lexon gazetë as radio nuk dëgjon.
S'e dij se ku gjen prehje a kënaqje,
në mos në shtrat, kur vete dhe pushon...

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
S H K O D E R

MIZANTROPI

Sa më pëlqejnë lulet dhe fëmijët!
Besoj se të pëlqejnë fort edhe ty.
Po njoh një lloj njeriu, që mund të rrijë
pa i shikuar dot ata me sy.

BIBLIOTEKA KOMBËTARE E SHQIPËRISË

PA TITULL

Kalon me kokën lart si kalli bosh
dhe matet fill me hijen e mëngjesit.
Pse veten derëziu e bën kaposh,
kur nuk e ka as dijen e këndezit?

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
S A R U D E R

MOSMIRËNJOHËSIT

I trashëgove tërë ato të mira
dhe nuk ia di aspak babait të ndjerë.
Kur do të keshë ditë të vështira,
mos prit nga djali të të bëjë nderë.

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
S H K O D E R

NJË PËRGJEGJËSI

Pse je përgjegjës i sektorit iks,
nuk do të thotë se di gjer në zeta.
Ti del në punë me orarin fiks,
po mbetesh prap aty te alfa beta.
Mëso nga vartësit, sepse pa ta
ti përnjimend nuk mund të dish gjithçka!

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
S H K O D E R

PËRGOJUESI

Njoh një njeri, që përgojon një botë.
Flet keq për ty me mua dhe të tjerë;
me ty për mua çfarë, ehe, nuk thotë!
Kështu «këndon» ai si gjinkall' në verë. . .
Për ta dënuar ka disa mënyra.
Mendoj t'ia heqim maskën nga fytyra.

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
S H K O D E R

NJË ZAGARI

Gjithkujt e bukura i pëlqen.
Gjithkush në të do t'donte pjesë.
Po s'shoh si ti njeri që vjen
e birret kaq me përdëllesë
pas çdo të bukure që sheh.
Ndaj për zagar gjithkush të njeh.

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
S H K O D E R

KUNDËR DYFYTYRËSISË

Një fytyrë ka njeriu
për vetvete e shoqëri.
Ai, q'e ndrron tek fryn veriu,
është kafshë e jo njeri.
Në njeh kënd me dy fytyra,
ma trego që t'ia përplas.
Shoqëria dhe natyra
më ndihmojnë ta godas.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "NAIM BERATI" SHKODËR



METES

Thua; «Mete, Mete, gjithkush për vete»
dhe kokën nuk e çan për asnjeri.
Po nuk të kapëm ty për veshi, Mete,
do të na prishësh krejt një shoqëri. . .

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

FUNDI I NJË ARROGANTI

Na ish një mot një arrogant me namë,
që, sa qe shef, gërthiti si çakall;
po ja, nga poshtë e lart, një ditë i ramë
me një kritikë vendçe mu në ballë,
aq sa t'iu shtrua punës bukuri
dhe zërin s'ia dëgjon më as në fqinj. . .

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER

PA PIKË PERSONALITETI

Ai është krejt një mendjeje me ty,
me mua është gjithashtu n'një mendje,
edhe pse ne s'pajtohemi të dy
për një problem, një fenomen, një gjendje.
Nuk don «të prishë» miqësi, i shkreti,
dhe mbet pa pikë personaliteti.

BIBLIOTEKA QENDRORE "MARIN BARLETI" SHKODËR

MBI VARRIN E NJË KONFORMISTI

Këtu pushon iks ipsiloni,
që, sa qe gjallë, u drodh si ngjalë,
ndërroi ngjyrën si kameleoni
dhe vdiq pa thënë dot një fjalë. . .

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
S H K O D E R

NJË PARAZITI

Puna, — tha i dijshmi, — krijoi njerinë.
Ajo, — tha, — është ligj i gjithësisë.
Kush nuk punon rëndoka njerëzinë
dhe duhet nxjerrë jashtë ligjësisë.

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
S H K O D E R

BUROKRATI

Mund të mos ketë syze e të mos jetë
kërrusur mbi një mal me shkresori,
po punën e zvarrit me ditë e netë
dhe i vesh konceptit t'vjetër petk të ri.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER

LIBERALIT

Së huajës iu qepe mu si rrodhe.
Me trup rron brenda dhe me shpirtin jashtë.
Për ne, që t'njohim, s'vlen as sa një krodhe,
ndaj të dënojmë me përçmim të vrazhdë.
Nga estetika hidhesh në etikë
dhe nga etika fill në politikë,
ndaj s'të lejojmë të na dredhësh bishtin,
të shesësh helm me Kafkën e me Krishtin. . .

BIBLIOTEKA E SHTETIT "MARIN BARLETI"

KONSERVATORIT

Je kapur pas së vjetrës dhe s'i shqitesh.
Pengesë e madhe sakt që na je bërë.
E vjetra të zateti prej kaq vitesh,
sa të ka zhveshur fare nga çdo vlerë.
Gjithkush përpara vjen e bën ca hapa,
ti, si gaforrja, ecën vithembrapa.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR



KUNDËR MASKARENJVE UNIVERSALË

Ne po ndërtojmë bashkërisht një botë,
që s'është parë në asnjë arenë,
ku të mos ketë fashistë a tjetër frotë,
Badherë e Koçër, hrushovianë e Tenë,
o maskarenj të tjerë universalë.
Ne në shënjestër tok i kemi vënë,
sa herë që në shteg na kanë dalë.
Ndaj tyre s'hedhim epigrame t'thjeshta,
po t'gjitha armët dhe malet me kreshta.

BIBLIOTEKA KOMBËTARE SHQIPËRIA

PËRMBAJTJA

Faqe

Epigramet 3
Portrete dhe syfete 4
Unë, Vehap Labi 5
Ai që është në lartësinë e detyrës 6
Vlera 7
Dituria 8
Kështillë 9
Asteizëm 10
Atij që e ka zemrën fort të bardhë 11
Sasi dhe cilësi 12
Një pensionisti 13
Një kukulle 14
Nuses 15
Vjehrrës 16

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

Faqe

Qeshem, se nuk mund për ty të qaj 17
Një sentimentalisti 18
Një kritiku letrar 19
Novatorizmin nuk e bën një novator i vetëm 20
Ai që bën si Tartarini 21
Kundër tifozllëkut 22
Kritikë 23
Dy «jetë» 24
Kundër smirës profesionale 25
Gënjeshtarit 26
Një koprraci 27
Atij që nuk shlyen borxhin 28
Vjedhësit të subjekteve 29
Moskokëçarësi 30
Mizantropi 31
Pa titull 32
Mosmirënjohësit 33
Një përgjegjësi 34
Përgojuesi 35
Një zagari 36
Kundër dyfytyrësisë 37
Metes 38
Fundi i një arroganti 39
Pa pikë personaliteti 40

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

Faqe

Mbi varrin e një konformisti 41
Një paraziti 42
Burokrati 43
Liberalit 44
Konservatorit 45
Kundër maskarenjve universalë 46

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
S H K O D E R

BIBLIOTEKA PUBLIKE
„MARIN BARLETI"
S H K O D E R

Bala, V.
Epigrame. T., «Naim Frashëri», 1979.
...f.
B-ka të mëdha dhe
B-ka të vogla: 891.983-1
B 21

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER

Tirazhi 1.500 kopje Format 70x100/32 Stash: 2204-72

KOMBINATI POLIGRAFIK — Shtypshkronja e Re,
Tiranë, 1979

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
S H K O D E R

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
S H K O D E R

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
S H K O D E R

Çmimi lekë 3